



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	20 . 11 3	viti god Year	
Organ /Njesia Organ /Jedintca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHTAC	7041/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1190/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1190/2023 të datës 21.09.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, me adresë banimi: Rruga _____, Komuna e Prishtinës, kundër vendimit me numër protokolli Nr.prot.2634 të datës 17.08.2023 dhe Vendimit me numër Nr.2780 të datës 31.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.11.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1190/2023 e datës 21.09.2023 e parashtruar nga ankuesja _____.
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.2780 i datës 31.08.2023 i Komisionit Disiplinor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses _____ : punësuar sipas Akt Emërimit me numër reference: 158/PRK-2 të datës 29.12.2022 në pozitën e punës „Zyrtar i Prokurimit“ në Departamentin e Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më datë 19.07.2023 Drejtori i Departamentit të Prokurimit ka parashtruar kërkesë për Inicimin e Procedurës Disiplinore.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 17.08.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoll Nr.prot.2634 përmes të cilit ka rekomanduar që të shqiptohet masa disiplinore e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1.1 të Ligjit (Nr.06/L-114) për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, ndërsa mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses gjegjësisht Drejtori i Prokurimit në AKP sipas rekomandimit dhe arsyetimit në Vendimin e Komisionit Disiplinor me datë 23.08.2023 i shqipton masën disiplinore „Vërejtje me shkrim“ për shkak të shkeljeve të etikes.

Me datë 01.08.2023 Drejtori Menaxhues i AKP-së dhe Drejtori i Prokurimit kanë parashtruar kërkesë për Inicimin e Procedurës Disiplinore ndaj ankueses, ndërsa më datë 31.08.2023 Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka nxjerr Vendim me numër protokoll Nr.prot.2780 përmes të cilit ankuesen e ka shpallur përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore sipas 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankueses masën disiplinore „Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej tre (3) muaj“.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2634 të datës 17.08.2023 dhe Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2780 të datës 31.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, brenda afatit ligjor komfor nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, më datë 21.09.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6177/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Vendimi i nxjerrë nga Komisionit Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është nxjerr me shkelje procedurale; vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 02.10.2023 ka pranuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit përgjigjen në ankesë me numër protokoll Nr.prot.3149 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër VK/2023 dhe numër të protokollit 6805/2023 të datës 01.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1190/2023 të parashtruar nga ankuesja Drita Gjonbalaj edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokoll 6177/2023 të datës 21.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër KD:03/2023 të datës 29.08.2023; Shqiptimin e Vërejtjes për Shkelje Disiplinore me numër ZQ/ZR:ZQ të datës 23.08.2023; Vendimin me numër

protokolli Nr.4/2634 dhe reference: KD-02/2023 të datës 17.08.2023; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër KD:02/2023 të datës 10.08.2023; Vendimin me numër protokoll Nr.4/2780 dhe reference KD-03/2023 të datës 31.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 02.10.2023; Formularin për raportimin e shkeljes disiplinore të supozuar në komisionin disiplinor (KD)/inicimin e procedurës disiplinore të datës 19.07.2023; Raportin informues dhe udhëzues nga Zyrtari për Standarde Profesionale - Agjencia Kosovare e Privatizimit të datës 19.06.2023; E-mail i datës 08.08.2023 nga A.L.G për D.Gj; Akt Emërimit me numër të referencës 158/PRK 2 së bashku me kushtet e punësimit të datës 28.12.2022; Përshkrimin e punës për titullin e punës Zyrtar i Prokurimit; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional (për periudhën Janar-Dhjetor 2021) të datës 13.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional të datës 31.01.2023; Dëshmi nga libri i evidentimit të datës 17.08.2023-31.08.2023; Vendimin me numër VK/2023 dhe numër protokoll 6805/2023 të datës 01.11.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja Drita Gjonbalaj, është e *pa bazuar*, sepse:

Ankuesja në ankesën me numër protokoll 6177/2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.2634 dhe numër reference: KD-02/2023 të datës 17.08.2023 dhe Vendimit me numër Nr.2780 dhe numër reference: KD-03/2023 të datës 31.08.2023 me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së këtyre dy (2) Vendimeve, ka bërë shkelje procedurale dhe materiale si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Andaj kërkon që të aprovohet ankesa si dhe të anulohet Vendimi me numër Nr.2634 dhe numër reference: KD-02/2023 i datës 17.08.2023 dhe Vendimi me numër Nr.2780 dhe numër reference: KD-03/2023 i datës 31.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Aktin e Emërimit me numër me numër reference: 158/PRK 2 të datës 29.12.2022 ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës „Zyrtare e Prokurimit“ në Departamentin e Prokurimit pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa ndaj të njëjtës Drejtori i Departamentit të Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, gjegjësisht Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë duke u bazuar në raportin e Zyrtarit për Standarde profesionale me numër Nr.02/2023 të datës 19.06.2023, më datë 19.07.2023 dhe me date 01.08.2023 ka parashtruar kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor, me arsyetimin se ankuesja ka vepruar në kundërshtim me standardet profesionale dhe dyshohet për veprim jo etik të zyrtarëve që bie ndesh me rregullat e mirësjelljes dhe dëmton imazhin e institucionit. Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 17.08.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoll Nr.prot.2634 përmes të cilit ka rekomanduar që të shqiptohet masa

disiplinore e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1.1 të Ligjit (Nr.06/L-114) për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, ndërsa mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses gjegjësisht Drejtori i Prokurimit në AKP sipas rekomandimit dhe arsytimit në Vendimin e Komisionit Disiplinor me datë 23.08.2023 i shqipton masën disiplinore „Vërejtje me shkrim“ për shkak të shkeljeve të etikës. Po ashtu me datë 31.08.2023 Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka nxjerr Vendim me numër protokoll Nr.prot.2780 përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar kërkesën për Inicimin e Procedurës Disiplinore ndaj ankueses të datës 01.08.2023 të parashtruar nga Drejtori i Prokurimit, ndërsa ankuesen e ka shpallur përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore sipas 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankueses masën disiplinore „Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej tre (3) muaj“.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankueses si dhe rrjedhshmërisë së shqyrtimit të lëndës lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses, fillimisht ka analizuar Vendimin me numër Nr.2634 dhe numër reference: KD-02/2023 të datës 17.08.2023, përmes së cilit është aprovuar si e bazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses Drita Gjonbalaj, gjithashtu në pikën II të dispozitivit është konstatuar shkelja si dhe përmes këtij Vendimi Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në pikën III të dispozitivit ka rekomanduar që të shqiptohet masa disiplinore e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1.1 të Ligjit (Nr.06/L-114) për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, dhe në baze të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit konkretisht librit të evidencës së pranimit të vendimeve ankuesja Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 17.08.2023 e ka pranuar po të njëjtën datë, andaj mbi këtë bazë dhe në vlerësim të Kolegjit të Këshillit, ankesa me numër protokoll 6177/2023 e datës 21.09.2023, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër Nr.2634 dhe numër reference: KD-02/2023 të datës 17.08.2023, është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”*, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesja nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afateve ligjore sipas dispozitave të lartpërmendura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Prandaj në kuptim të kësaj, ankesa e ankueses Drita Gjonbalaj kundër Vendimit me numër Nr.2634 dhe numër reference: KD-02/2023 të datës 17.08.2023 të Komisionit Disiplinor, është e pa lejuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankueses lidhur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2780 përmes së cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndalim prej 20% të pagës për periudhën prej tre (3) muaj“, me arsytimin se e njëjta është përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore konkretisht *„Shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil”* të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimet e ankueses dhe ka analizuar dëshmitë e ofruara nga palët konkretisht Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore si dhe rrjedhshmërisë së shqyrtimit të lëndës disiplinore ndaj ankueses, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se më datë 12.05.2023 Drejtori i Administratës ka dorëzuar tek

Zëvendësuesi i Zyrtarit për Standarde Profesionale, kërkesë për inicim rasti kundër ankueses për shpifje ndaj zyrtareve/kolegeve, tejkalim të detyrave dhe përgjegjësive në këtë proces dhe sjellje të pahijshme ndaj zyrtareve të AKP-së, si dhe punëtoreve të kompanisë së pastrimit të xhamave. Zëvendësuesi i Zyrtarit për Standarde Profesionale me datë 18.07.2023 e ka njoftuar Drejtorin Menaxhues se në të njëjtën ditë e ka ndërprerë shqyrtimin e rastit, për shkak se pas intervistimit ka ushtruar presion dhe tentim për frikësim në kryerjen e punës se tij konkretisht duke i thënë „se nëse nuk e shqyrton drejt këtë çështje do të akuzoj tek organet e rendit“, andaj Zëvendësuesi i Zyrtarit për Standarde Profesionale këtë rast e ka raportuar tek Drejtori Menaxhues për shkelje të kodit të mirësjelljes. Andaj duke marrë parasysh faktet e lartcekura Drejtori Menaxhues dhe Drejtori i Prokurimit bazuar në nenin 48 paragrafin 4 nën paragrafin 4.1 dhe 4.2 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë se bashku me datë 01.08.2023 kanë parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor kundër ankueses dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se Drejtori Menaxhues në këtë rast është autoriteti më i lartë ekzekutiv/administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale, kështu që i njëjti sipas dispozitave të lartcekura ka të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor në pajtim me nenin 48 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku është përcaktuar se: “4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit”, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses nga Drejtori Menaxhues dhe Drejtori i Prokurimit është në pajtim me dispozitat e lartcekura.

Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e legjislacionit material që rregullojnë fushën e përgjegjësisë disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore të paracaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “45. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit; 46. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të paracaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë” dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mbajnë përgjegjësi disiplinore në rastet kur konstatohet se të njëjtit me veprim ose mosveprim kanë shkelur dispozitat e ligjit material dhe

legjislacionit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbajnë, mirëpo vetëm nëse për një çështje të tillë plotësohen parakushtet ligjore për zhvillimin e procedurës disiplinore në pajtueshmëri me Rregulloren Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sikurse personat zyrtar po ashtu janë përgjegjës nëse në cilësi të autoritetit zyrtar përkitazi me mandatin ligjor që buron nga akti i themelimit të marrëdhënies së punës të ndërlidhur me përshkrimin e detyrave të punës në kuptim edhe të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1 dhe 2, dhe nenin 8 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nëse të njëjtit kryejnë veprime që cenojnë apo shkelin parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, parimin e objektivitetit dhe paanësisë, parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme të ndërlidhura me përgjegjësinë për procedurën dhe vendimmarrjen në kuadër të autoritetit zyrtar që ushtron sipas mandatit që ia ka njohur ligji material.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, me rastin e parashtrimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”*, ndërsa Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.prot.2780 të datës 31.08.2023, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesja, dhe i njëjti në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses, është në përputhje me gjendjen faktike sepse Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka konstatuar që ankuesja ka bërë shkelje të përsëritura të kodit të etikës, respektivisht në këtë rast Kolegji i Këshillit, mori për bazë masën disiplinor „Vërejte me shkrim” të datës 23.08.2023 e cila ka të bëjë me shkelje të rregullave të etikës nga ana e ankueses, mirëpo që ankuesja në ankesën e saj të parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përveç që e përmend si procedurë, të njëjtën nuk e ka kontestuar përmes kësaj ankese dhe nuk ka kërkuar që e njëjta të anulohet apo të shfuqizohet, andaj si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja para nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.2780 të datës 31.08.2023 të Komisionit Disiplinor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka pasur të shqiptuar një masë disiplinore për shkelje të njëjta dhe rrjedhimisht Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.2780 të datës 31.08.2023 ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 45, 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa ky vendim është arsyetuar në përputhje të plotë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankueses ndaj këtij vendimi janë pretendimet të pabazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete, sepse ankuesja me veprimet e saj me

sjelljet kërcënuese ndaj zyrtarëve ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 dhe 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1190/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses .
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.